

Informacioni i standardizuar parakontraktor i kredisë konsumatore

Ju lutemi të lexoni me vëmendje informacionin parakontraktor të paraqitur në këtë dokument i cili përmban informacionin kryesor lidhur me produktin e kredisë së kërkuar.

Nënshkrimi i këtij dokumenti nga ana juaj përbën marrje dijani të informacionit parakontraktor, por nuk detyron ECFA SHPK të miratojë kërkesën tuaj për kredi apo të lidhë kontratë me ju.

1. Emri dhe detajet e kontaktit të institucionit kredidhënës

Kredidhënësi	ECFA SHPK
Adresa	Rruga "Muhamet Gjollesha", Ndertesë Tirana Ring Center, Nr. 8, Kati i 9-te, Tirane, Albania
Numri i Telefonit	+355 44 500 600
Adresa e postës elektronike	info@kredo.al
Adresa e Web-it	www.kredo.al
Vendi i ofrimit	

2. Përshkrimi i karakteristikave kryesore të produkteve të kredisë

Lloji i kredisë	Linjë kredie konsumatore pa kolateral.
Vlera totale e kredisë dhe monedha. (Nënkupton kufirin maksimal ose shumën totale të disponueshme, të kredisë)	Monedha*: ALL Shuma: XXXX.00 ALL *ECFA SHPK ju tërheq vëmendjen për rrezikun që paraqet për ju kredimarrja në valutë, veçanërisht kur të ardhurat tuaja janë në lekë dhe mund të ketë lëvizje të pafavorshme të kursit të këmbimit.
Kushtet që rregullojnë tërheqjen e fondeve. (Nënkupton si dhe kur do merren paratë)	Kredia do të lëvrohet sipas zgjedhjes së Klientit, me para në dorë në një nga degët e ECFA SHPK ose në një nga pikat e Western Union, Easy Pay. Për të shmangur Komisionin e Lëvrimit me para në dorë, ju rekomandojmë të zgjidhni lëvrim me transfertë bankare në një llogari tuajën personale të hapur në një nga bankat e nivelit të dytë në Shqipëri
Kohëzgjatja e kontratës së kredisë	Kontrata e linjës së kredisë lidhet për një afat të pacaktuar dhe mund të zgjidhet në përputhje me kushtet e saj.
Këstet dhe, kur është e mundur, mënyra se si do të shlyhen këstet.	Konsumatori duhet të paguajë: Çdo datë: 01.01.2024 Me Frekuencë mujore përgjatë: XXX ditë (X këste) Vlerë Kësti: XXXX.00 ALL Në vlerën e këstit, përfshihet shlyerja e principalit, interesit , komisionit të administrimit , komisionit të angazhimit dhe komisionit të lëvrimit kesh (nëse është lëvruar me kesh) Këstet do të paguhet në monedhën e kredisë, në një prej degëve të ECFA SHPK, apo në një nga pikat e Western Union, Easy Pay, ose në çdo llogari bankare të ECFA SHPK: BKT BANK: AL37 2051 1227 0033 69 CLPRCLALLA Raiffeisen Bank: AL13 2021 1130 0000 0000 2132 6338 Credins Bank: AL40 2121 1212 0000 0000 0100 2347 Intesa San Paolo Bank: AL13 2081 1008 0000 0209 5473 5301 Union Bank: AL49 2141 1182 0198 5781 5672 0113 Tirana Bank:AL77 2061 1042 0000 1403 2291 4101 OTP Albania Bank:AL08 2131 1044 0000 0000 0223 8980 ECFA SHPK ju ofron gjithashtu edhe mundësinë e shtyrjes së datës së pagesës kundrejt një Tarife (lexo ne fund).

¹ Kostoja e kredisë është llogaritur sipas tarifave/komisioneve në fuqi në datën e pranimit të këtij dokumenti. Tarifat/komisionet e kredidhënësit mund të ndryshojnë në të ardhmen, sipas kushteve kontratës së kredisë.

Shuma totale që konsumatori do të ketë për të paguar.	XXXXX.00 ALL
Garanci/siguri të nevojshme. 3. Kostoja e kredisë	E pazbatueshme. ECFA SHPK nuk kërkon garanci apo sigurim të kontratës.
Norma e interesit të kredisë që do të aplikohet në marrëveshjen e kredisë.	Normë fikse vjetore e interesit për kredinë në masën 0.00%, e aplikuar mbi kredinë e mbetur.
Norma efektive e interesit (NEI)% Është totali i kostos së kredisë për klientin, e shprehur si përqindje vjetore e vlerës së kredisë së dhënë dhe e llogaritur në përputhje me nenin 6 dhe aneksin nr. 1 të rregullores nr. 59 “Mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare”.	0.00% Norma efektive e interesit ka të përcaktuar një normë maksimale sipas rregullores së Bankës së Shqipërisë, e cila është norma efektive e interesit e llogaritur si mesatare e normës efektive të interesit të aplikuar nga cdo institucion kredidhënës gjatë një 6 mujori, duke shtuar edhe një të tretën e saj. Kjo normë vendoset në fund të çdo gjashtëmujori për gjashtëmujorin vijues nga Banka e Shqipërisë dhe botohet në faqen e saj zyrtare të internetit; Për 6 mujorin e dytë të vitit 2024 ky maksimum për kreditë konsumatore është: vlerë kredie nga 0 - 200,000 ALL maksimum prej 95.19% ; vlerë kredie nga 200,001 - 600,000 ALL maksimum prej 37.43%; vlerë kredie nga 600,001 - 2 milion ALL maksimum prej 16.20% Shembull: Klienti tërheq kredi në vlerën 40,000 ALL. Supozojmë që ai e mban të plotë 12 muaj këtë kredi dhe e paguan atë në fund të maturimit të marrëveshjes. Në këtë mënyrë, klienti do të paguajë për 12 muaj rresht një kësht prej 4,690 ALL (interes dhe komisione). Pra në total gjatë 12 muajve klienti paguan 56,310 ALL. Në formulën më poshtë “i” është NEI $40,000 = 4,690 / [(1+i)]^{30/365} + 4,690 / [(1+i)]^{30/365} + \dots$ (10herë). Atëherë “i” me këtë formulë është 0.9387 dhe rrjedhimisht NEI shprehet si 93,87%
Komision administrimi i kredisë në vonesë	1,000 ALL. E pagueshme në rastet kur ju jeni me vonesë në pagimin e kësteve të Kredisë. Ky Komision do të aplikohet në ditën 22-të, 45-të dhe 61-të vonesës, për të mbuluar kostot operacionale që i shkaktohen institucionit gjatë procesit të administrimit të kredive në vonesë. Gjithashtu, në ditën e 61-të të vonesës do t’ju dërgohet nga ECFA SHPK edhe një Letër Njoftuese dhe Informuese lidhur me totalin e detyrimitve tuaja.
A është e mundur të përfitohet kredia sipas kushteve të punës në të cilat tregtohet, duke përjashtuar kontratat e sigurimit për kredinë?	ECFA SHPK nuk kërkon garanci apo sigurim të kontratës.
Kosto të tjera të lidhura me kredinë.	Komision administrimi: XXX.00 ALL Komision angazhimi: XXX.00 ALL
Çdo kosto shtesë që është e detyrueshme për përfitimin e kredisë.	Nuk ka kosto të tjera shtesë veç atyre të përcaktuara më lart.
Shuma e kostove për përdorim të caktuar të një pagese	ECFA SHPK merr përsipër të gjitha komisionet e ngarkuara nga banka të nivelit të dytë kur ju kërkon që kredia juaj të lëvrohet nëpërmjet një transferte bankare në një llogari bankare tuajën. Në rast se klienti kërkon që kredia t’i lëvrohet në kesh pranë degës sonë ose në një nga pikat e Western Union, atëherë Klienti do të ngarkohet me një Komision për Lëvrim Kesh në vlerën 14% mbi vlerën e lëvruar, e pagueshme sipas përzgjedhjes së Klientit (gjatë lëvrimit ose e shpërndarë si detyrim në grafikun e pagesave) Në rastet kur kërkohet që kredia të lëvrohet në kesh: XXXX.00 ALL
Kosto të tjera që rrjedhin nga kontrata e kredisë.	Janë komisione apo tarifa që mund të lindin gjatë jetëgjatësisë së huasë ose kur kërkohet një shërbim nga kredimarrësi dhe bëhen të ditura herë pas here sipas tabelës së traifave dhe interesave në fuqi. Këto komisione mund të lidhen, por pa u kufizuar me shërbime që kredimarrësi merr pranë kredidhënësit lidhur me kredinë e tij, shërbimin e pagesave etj.
Kushtet, sipas të cilave kostot e sipërpërmendura që kanë të bëjnë me kontratën e kredisë mund të ndryshojnë.	Çdo ndryshim në kontratën e kredisë do t’ju njoftohet me email apo sms apo çdo mënyrë tjetër njoftimi të parashikuar në kontratën e kredisë. Klientit do t’i jepen 15 ditë për të miratuar apo refuzuar ndryshimet në kontratë.
Detyrimi për të paguar shpenzimet materiale.	Nuk ka shpenzime materiale.

¹ Kostoja e kredisë është llogaritur sipas tarifave/komisioneve në fuqi në datën e pranimit të këtij dokumenti. Tarifat/komisionet e kredidhënësit mund të ndryshojnë në të ardhmen, sipas kushteve kontratës së kredisë. Kostot në rastin e pagesave me vonesë.

Në rast pagese të vonuar të detyrimeve sipas kontratës së kredisë, ECFA SHPK aplikon një tarifë vonese prej 2% për çdo ditë vonese e përlllogaritur mbi vlerën totale të pagesës të papaguar në vonesë. Në çdo rast kur kamatëvonesa e papaguar arrin në masën 30% të totalit të detyrimit të papaguar në vonesë, kjo kamatëvonesë nuk rritet më në vijim, derisa të paguhet pjesërisht ose e plotë.

Shembull i përlllogaritjes së kamatëvonesës:

Supozojmë se për një këst pagese kemi 1,000 ALL Principal + 50 ALL Interes + 10 ALL Komision. Në rast se ky këst nuk paguhet në datën e përcaktuar në grafikun e pagesave, dhe pagesa rezulton me një ditë vonese, gjoha e vonesës përlllogaritet: $1,060 * 2\% = 21.2$ ALL.

Në ditën e dytë, kjo gjobë do të jetë $21.2 * 2 = 42.4$ ALL, dhe me rritjen e ditëve të vonesës, gjoha rritet për çdo ditë vonese me vlerën 21.2 ALL, deri kur arrin maksimumin e saj të lejuar.

4. Aspekte të tjera të rëndësishme ligjore

Procesi i aplikimit

Ju mund të aplikoni në faqen zyrtare të ECFA SHPK, ku do të pajiseni me disa kredenciale për t'u loguar më pas çdo herë dhe për t'u njohur me informacion mbi ecurinë e procesit të kërkesës për kredi, si dhe me informacionin mbi kredinë aktive nëse lidhet një marrëveshje kredie mes nesh.

Ju gjithashtu, mund të aplikoni për kredi pranë çdo dege të ECFA SHPK të cilat janë në shërbim të klientit çdo ditë (e hënë - e diel) sipas orarit të publikuar në faqen tonë zyrtare www.kredo.al/deget.

Dokumentacioni i kërkuar gjatë aplikimit

Dokumentacioni i përhershëm pavarësisht produktit të ofruar, që duhet të keni me vete sa herë paraqiteni pranë degëve të ECFA SHPK është Pasaporta ose Karta e Identitetit.

Gjithashtu, ju duhet të keni me vete dhe telefonin tuaj, me të cilin shkëmbehen disa sms konfirmimi gjatë procesit të shqyrtimit të kërkesës dhe disbursimit të kredisë.

Pajisja me dokumentacion gjatë jetës së kredisë dhe pas mbylljes së marrëveshjes së kredisë

Menjëherë pas nëshkrimit të Marrëveshjes së Kredisë, ju pajiseni me një prej origjinaleve të kësaj kontrate. Çdo dokument tjetër që është paraqitur gjatë procesit të vlerësimit të kredisë mbetet me ECFA SHPK në dosjen tuaj të kredisë dhe ju nuk keni të drejtë për ta tërhequr atë, vetëm në rast se dokumentacioni përbën dokument unik origjinal të ndonjë pronësie. Gjatë jetës së kredisë, ju mund të kërkonte kopje tjetër të Marrëveshjes së Kredisë, për të cilën ju do të duhet të paguani në momentin e pajisjes me këtë kopje një komision shërbimi në vlerën 2,000 ALL.

Në çdo rast kur ju nevojitet lëshimi i një dokumenti nga ECFA SHPK mbi statusin e marrëveshjes së kredisë tuaj, ju do të pajiseni me të kundërt një komisioni shërbimi në vlerën 2,000 ALL.

E drejta për t'u tërhequr.

Klienti ka të drejtë të tërhiqet nga kontrata e kredisë, pa kosto shtese, brenda një afati 14 (katërmëdhjetë) ditor nga data e nënshkrimit të saj duke i dërguar ECFA SHPK një njoftim me shkrim për këtë qëllim. Po__ Jo__.

Kjo e drejtë nuk mund të ushtrohet në rastet e shtesave të kontratës kryesore të kredisë.

Klienti do të duhet të shlyejë me kthimin e kredisë brenda 14 ditëve, edhe vlerën e interesit, komisionin e administrimit dhe komisionin e angazhimit të përpjesëtuar për ditët e përdorimit të kredisë. Në rastet kur është lëvruar në kesh, paguhet i plotë dhe komisioni i lëvritit me para në dorë.

Në rastin kur institucioni financiar ofron një shërbim ndihmës në lidhje me Kontratën e Kredisë, në bazë të një kontrate me një palë të tretë, kredimarrësi nuk do të ketë më detyrime nga kontrata nëse ai ushtron të drejtën e tërheqjes nga kontrata e kredisë.

¹ Kostoja e kredisë është llogaritur sipas tarifave/komisioneve në fuqi në datën e pranimit të këtij dokumenti. Tarifat/komisionet e kredidhënësit mund të ndryshojnë në të ardhmen, sipas kushteve kontratës së kredisë.

Shlyerja (pagesa) e kredisë para afatit të maturimit.	Klienti mund të parapaguajë një pjesë apo të tërë detyrimin sipas kontratës së kredisë në çdo kohë përpara afatit të maturimit duke reduktuar kështu koston totale të kredisë. Klienti do të duhet të njoftojë me shkrim për këtë pagesë para afatit Kredidhënsin.
Kosto në rastin e shlyerjes së kredisë para afatit të maturimit.	Në rast parapagimi, ECFA SHPK do të mbajë një komision mbi vlerën e principalit të mbetur prej 0.5 % të shumës së kredisë së paguar para afatit, nëse periudha midis shlyerjes para afatit dhe maturimit të kredisë nuk kalon 1 vit, dhe 1 % të shumës së kredisë së paguar para afatit, nëse periudha midis shlyerjes para afatit dhe maturimit të kredisë është mbi 1 vit. Gjatë shlyerjes përpara afatit, interesi dhe komisioni i administrimit paguhen në përpjesëtim me ditët e përdorura, ndërkohë që Komisioni i Angazhimit dhe Komisioni për lëvrim me para në dorë (nëse është zgjedhur ky opsion) paguhen të plota.
Informimi në rast refuzimi të kredisë.	Në rast refuzimi të aplikimit tuaj për kredi, refuzimi dhe arsyet e refuzimit do t'ju njoftohen personalisht në degë, me sms në numrin tuaj të telefonit apo me e-mail në rastet kur keni regjistruar një adresë e-maili në kontaktet tuaja.
E drejta e pajisjes me kopjen e Projekt Kontratës së Kredisë.	Konsumatori ka të drejtë me kërkesën e tij të pajiset me kopje Projekt-Kontratë Kredie. Kjo e drejtë nuk do të ushtrohet nëse institucioni financiar nuk do të vazhdojë me nënshkrimin e kontratës së kredisë me konsumatorin.
Mënyra e njoftimit, si dhe mënyra e marrjes së pëlqimit të konsumatorit në rastin e ndryshimeve të kushteve, të cilat sjellin pasoja në bazë të kontratës.	Çdo ndryshim në kontratën e kredisë do t'ju njoftohet me e-mail apo sms apo çdo mënyrë tjetër njoftimi të parashikuar në kontratën e kredisë. Klientit do t'i jepet një afat i caktuar për të miratuar apo refuzuar ndryshimet në kontratë.
Skema e brendshme e ankimimit të konsumatorit kundrejt ECFA SHPK.	Për çdo problem apo ankesë që ju dëshironi të ndani me ECFA SHPK, jeni të lutur të kontaktoni në numrin Call Center +355 44 500 600; dhe në adresën info@kredo.al. Ju do të merrni një përgjigje për kërkesën tuaj brenda 24 orëve.
Komisioni për Shtyrje Pagese:	Shtyrje të datë pagesës me 30 ditë, me tarifë 35% perlllogaritur mbi totalin e vlerës së kështit që po shtyhet. Një kësht mund të shtyhet vetëm 1 herë, më pas duhet paguar kështi i plotë dhe kështi i radhës mund të shtyhet përsëri me një herë.
Periudha kohore gjatë së cilës ECFA SHPK ka detyrime që rrjedhin nga informacioni parakontraktor.	Ky informacion është i vlefshëm prej datës 01.01.2024 deri në datën 01.01.2024

Konsumatori

(Konfirmon marrjen e informacionit parakontraktor)

(Emër Mbiemër, Nënshkrimi)



1

Ti mund ta shtysh datë pagesën me 30 ditë!



2

Shtyrja aktivizohet vetëm kur paguhet Tarifa për Shtyrje



3

Hyr në profilin tënd për t'u informuar mbi Tarifën e Shtyrjes!



4

Ti mund të përdorësh 1 shtyrje për çdo kësht!

¹ Kostoja e kredisë është llogaritur sipas tarifave/komisioneve në fuqi në datën e pranimit të këtij dokumenti. Tarifat/komisionet e kredidhënsit mund të ndryshojnë në të ardhmen, sipas kushteve të kontratës së kredisë.